

REKOMANDIME PËR PLANIN VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2025–2027 PERMET

Duke u bazuar në detyrimet ndërkombëtare që rrjedhin nga konventat dhe marrëveshjet e ratifikuara në fushën e barazisë gjinore dhe parandalimit të dhunës në familje ku ndër më të rëndësishmet veçojmë Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), Deklaratën dhe Platformën për Veprim të Pekinit, si dhe Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) të lexuara në harmoni me instrumente të tjera ndërkombëtare si Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, është thelbësore të kuptohet se barazia gjinore përbën një të drejtë themelore. Kjo e drejtë duhet të garantohet dhe promovohet nga organet e qeverisjes vendore dhe rajonale në të gjitha fushat e përgjegjësisë së tyre, përfshirë edhe detyrimin për të eliminuar të gjitha format e diskriminimit – të drejtpërdrejta apo të tërthorta.

Në këtë kuadër, sugjeroj që në Planin Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore të adresohen dy komponentë themelore:

1. Përfshirja e perspektivës gjinore në buxhetim

Ky komponent nënkupton integrimin e perspektivës gjinore në të gjitha fazat e planifikimit dhe buxhetimit vendor, për të siguruar që burimet të shpërndahen në mënyrë të drejtë dhe efektive në funksion të barazisë gjinore. Sjell ne vemendje ketu dhe praktiken gjyqesore qe ka interpretuar barazine e te drejtave si parim themelore baze, kushtetues qe lidhet me mundwsi te barabarta ne kushte objektivisht te njejta.

Cfare mund te behet ne kete drejtim?

- Zhvillimi i masave mbështetëse për gratë sipërmarrëse përmes lehtësive në taksat vendore ose mbështetjeje të tjera financiare. Nëse nga të dhënat rezulton se përqindja më e lartë e sipërmarrjeve të reja në Përmet janë të hapura nga gra, atëherë këto ndërhyrje duhet të kenë fokus afirmues
- Krijimi i pozitës së një nëpunësi të posaçëm për çështjet e barazisë gjinore në strukturën administrative të bashkisë. Ky pozicion duhet të jetë me kohë të plotë dhe nuk duhet konsideruar si barrë buxhetore, por si domosdoshmëri për përmbushjen e detyrimeve ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore.

2. Zvogëlimi i stereotipeve gjinore dhe nxitja e pjesëmarrjes së barabartë në vendimmarrje

Pjesëmarrja e barabartë gjinore nuk duhet të matet vetëm në mënyrë numerike, por edhe në aspektin cilësor të angazhimit në vendimmarrje. Stereotipet gjinore në kontekstin lokal shpesh shërbejnë si pengesë për përfshirjen efektive të grave dhe vajzave në proceset politikberese.

Cfare mund te behet ne kete drejtim

- 1- Krijimi i një mekanizmi të brendshëm për vlerësimin e punës së këshilltarëve bashkiakë, jo me qëllim për të krijuar imazh negative mbi integritetin e punës së secilit këshilltar, por për të nxitur secilin anëtar që gjatë mandatit të ndërmarrë iniciativa, të propozojë politika dhe të ngrejë problematika që lidhen me komunitetin dhe perspektivën gjinore;

Ky vlerësim mund të realizohet nga vetë struktura e Këshillit Bashkiak në mënyrë transparente dhe objective Në përfundim të mandatit, çdo këshilltar duhet të ketë një “portofol” të angazhimit të tij, ku të dokumentohen iniciativat e ndërmarrë dhe propozimet që lidhen me barazinë gjinore apo përfaqësimin e grupeve të nënpërfaqësuar; Në këtë mënyrë krijohen indikatorë matës që mundësojnë vlerësimin e iniciativave të ndërmarrë nga gjinitë më pak të përfaqësuar, në këndvështrimin e ndërhyrjeve apo llojeve të ndërhyrjeve të propozuara në komunitet."

Ne kuadër të rekomandimeve dhe sugjerimeve që kam cituar më sipër bashkëngjitur po ju sjell dhe një praktikë që kanë ndjekur shtetet europiane në këtë drejtim – PRA NE DREJTIM TË PËRFAQËSIMIT GJINOR BARAZISË GJINORE SI QWLLIM DHE STRATEGJI VEPRIMI NE PUNEN E PUSHTETIT LOKAL.

- *Shenim – ne vijim po paraqes disa praktika që janë lehtësisht të “beshme” në praktiken e punës së Bashkisë. Permet në këtë drejtim. Bashkëngjitur si ilustrim gjeni dhe linkun përketes për më shumë hulumtim si praktike nëse do gjendet me interes.*

<https://www.cge.asso.fr/publications/barometre-egalite-femmes-hommes-infographie-2025/>

“Baromètre de l’égalité femmes-hommes” është një praktikë që ndiqet nga disa bashki në Francë dhe konisiton në një raport që ata e paraqesin si infografike dhe që pasqyrojnë nivelin e barazisë gjinore në fushat e kompetencës vendore të bashkive sipas ligjit përkatës. P.sh. përfaqësimin gjinor në strukturat politike dhe administrative; qasjen gjinore në shërbime si kultura, sporti, transporti, edukimi etj.

Një tjetër metodë e përdorur në Francë dhe Itali për integrimin e politikave të barazisë gjinore në mënyrë efektive në punën e përditshme të autoriteteve lokale – krijimi i forumeve të grave (ato i quajne laboratore sociale) në çdo njësi administrative. Këto do të jenë grupe që do “përdoren” për të konsultuar nisma të ndryshme lokale, kjo për të dhënë zë të grupeve të nënpërfaqësuar kryesisht në zonat rurale.